  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendrojev e)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	“Ruajtja dhe siguria fizike me roje private për UKT sh.a “ (9 vendroje me shërbim 24 ore)	12	11			
2	“Shoqërimi i vlerave monetare për UKT sh.a“	12	23			
		<b>Oferta Neto ne total</b>				
		<b>TVSH (%)</b>				
		<b>Oferta total</b>				

## Sqarime

1. Ne çmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vendroje me 3 turne , me koeficient 4.98 roje në muaj, sipas tabelës së mëposhtme:

Preventiv

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per 1 njesi (2 punonjes) ne muaj per shoqerimin e vlerave monetare sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Kosto Sherbim Shoqerimi</b>	
<b>A. Paga baze mujore per 2 punonjes</b>	
<b>Sigurimet shoqerore</b>	
<b>Total Shuma</b>	
<b>B.Fitim dhe shpenzime admin</b>	
<b>Total shum</b>	
<b>C. Shpenzimet e transportit</b>	
<b>Lende djegese</b>	
<b>Taksa , mirembajtje dhe siguracion</b>	
<b>Shpenzime per Autorizime te Blindave</b>	
<b>Total Shuma</b>	
<b>Fitimi i Shoqerise</b>	
<b>Totali A+B+C</b>	

## Analiza e kostos

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM,"nr.113, datë 01.03.2023 "Për percaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr.7961, datë 12.7.1996, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, legjislacionin per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne fuqi si dhe cdo detyrim tjeter ligjor ne fuqi.
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).

- 
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
  - Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Afatet e lëvrimit:**

Ne tabelen me poshte po ju japim detajet e objekteve, oren e sherbimit

<b>Nr</b>	<b>Emertimi i objekteve qe ruhen</b>	<b>Nr. Vendrojeve</b>	<b>Koha e ruajtjes (ore/dite)</b>
1	Zyrat Qendrore te Shoqerise UKT	1	24 (7-dite)
2	Impjanti Boville	4	24 (7-dite)
3	Nyja Hidroteknike Boville	3	24 (7-dite)
4	Spektori 8 (zona afer ures) Qafe Molle	1	24 (7-dite)
5	Spektori 9 (vend bur/Selites) Qafe Molle	1	24 (7-dite)
6	Magazinat e Shoqerise ne Brar	1	24 (7-dite)
	<b>Totali</b>	<b>11</b>	
1	shoqerimi i vlerave monetare me roje nga Arka ne Banke (Arkat ,KNK dhe Njesite)	23	Sipas kerkeses se AK per oraret e njesive te ndryshme

<b>Nr</b>	<b>Nr. Vendrojeve</b>	<b>Orët e punës</b>	<b>Turnet</b>
1	11	24 orë për 7 ditë	I+II+III

2	23	Arkat ,KNK dhe Njesite, shoqerimi i vlerave monetare me roje nga Arka ne Banke	Sipas kerkeses se AK per oraret e njesive te ndryshme
---	----	--	---

Objektet të cilat kërkohen të ruhen me arme të kategorisë B4 (arme të gjata) janë si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i objekteve që do të ruhen me armë	Nr. Vendrojeve	Koha e ruajtjes (orë/ditë)
1	Impjanti Bovillë	4	24 (7-ditë)
2	Nyja Hidroteknike Bovillë	3	24 (7-ditë)
3	Spektori 8 (zona afër urës) Qafë- Mollë	1	24 (7-ditë)
4	Spektori 9 (vend bur/Selitës) Qafë- Mollë	1	24 (7-ditë)

Nr	Nr. Vendrojeve	Orët e punës	Turnet
1	11	24 orë për 7 ditë	I+II+III
2	23	Arkat , KNK-të dhe Njësitë, shoqërimi i vlerave monetare me roje nga Arka në Bankë.	Sipas kërkeses të AK për oraret e njësive të ndryshme.

**Per te gjitha Arkat dhe Njesite, shoqerimi i vlerave monetare me roje nga Arka ne Banke do te kryhet ne këto orare:(Per kete sherbim kerkohet sherbim ne kategorine 1.3.B.)**

**E Henë – e Premte ne oren 15:30-18:00**

**Te shtunen ne oren 13.00-16:00**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Ruajtja dhe Siguria Fizike ne roje private dhe shoqerimi i vlerave monetare per UKT sh.a.

**Detyrat:**

Shërbimi natën të kryhet me roje të armatosura.



---

Rojet duhet te jene te pajisura me uniforme pa te cilen nuk pranohen ne shërbim si dhe mjet identifikimi me fotografi.

Rojet duhet te kenë shenjen dalluese te shoqërisë sipërmarrëse.

Rojet duhet te jene te pajisur me liber sherbimi ku per cdo subjekt qe do te paraqitet prane zyrave apo puseve te cilat jane ne ruajtje duhet te firmosin librin e sherbimit.

Te organizoje ruajtjen dhe sigurinë ne çdo post shërbimi, gjithashtu ruan, mbikëqyr dhe kontrollon gjithë territorin qe shikohet nga vendroja, duke parandaluar dëmtimin e pronës së punëdhënësit.

Të mbulojë të gjitha shpenzimet si paga të rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlydhje si dhe gjithë kompensimet e tjera të njohura me ligj.

Ne vendroje me shërbim te diferencuar, jo te vazhdueshëm, me mbarimin e ndërresës, roja ia dorëzon shërbimin personit te ngarkuar nga drejtuesi i shërbimit te kësaj vendroje, sipas rastit përgjegjësit te administratës dhe personave te caktuar prej tij.

Rojet mbikëqyrin zbatimin e rregullit te brendshëm dhe nuk lejojnë hyrjen e personave te jashtëm (qe nuk janë personel i SH.A.Ujesjelles – Kanalizime ) pa autorizimin përkatës (leje) lëshuar nga personi kompetent.

Roja ne shërbim ndalon rreptësisht (dhe forcërisht) futjen dhe nxjerrjen ne/dhe nga objekti te materialeve, mallrave, aparaturave, pajisjeve etj., pa dokumentin përkatës siç mund te jete, flete hyrje, fletëdalje, urdhër punimi etj, ne te cilin caktohet personi i ngarkuar dhe te jete firmosur nga personi i autorizuar.

Roja parandalon dhe merr masa (kur ndodhin) për evidentimin e rasteve flagrante kur nga persona te jashtëm (ose te brendshëm) te prishjes se rendit ose kur cenohet integriteti i personit.

Te bashkepunoje sipas ligjeve ne fuqi, me policine e shtetit dhe me organe te tjera kompetente shtetore kur lind nevoja.

Sipërmarrësi mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objektin që ruhet nga ana e tij kur këto vijnë si rezultat i mungesës së vigjilencës të rojeve dhe mosorganizimit të mirë të shërbimit. Në këto raste sipërmarrësi detyrohet të bëjë çdëmtimin e pasurisë së vjedhur apo dëmtuar në masën 100% të vlerës së dëmtuar.

-Te ruaj dhe siguroj objektet dhe vlerat materiale brenda tyre me perkushtim .

-Para marrjes se sherbimit te kontrolloje objektet ne prani te rojes dorezuese dhe per cdo problem te konstatuar te njoftoje pergjegjesin e rojeve.

-Per te marre kryerjen e sherbimit roja duhet te paraqitet 15 minuta para orarit .

- Roja nuk duhet te largohet nga vendi i sherbimit pa u zevendesuar nga roja pasardhese.

-Roja duhet te zbatoje vetem urdhrat e pergjegjesit te rojeve dhe titullarit te institucionit.

---

- 2 punonjes Shoqerimi i vlerave monetare per ne banke punonjes sherbimi te cilet do te bejne shoqerimin e punonjesve arketare te sh.a.U.K. per ne banke ne ditet nga e hene deri te shtunen, turni i pare ne te gjithë veprimtarine ku ka sh.a.Ujesjelles-Kanalizime. Punonjesi i sherbimit te rojes duhet te jete i armatosur me arme zjarri, me uniforme te rregullt me shenja dalluese dhe aparature te sistemit te radionderlidhjes ne gjendje te mire teknike.

Koha e gadishmerise dhe menyra e veprimit dhe nderhyrjes ne situata te jashtezakonshme, konform ligjit nr.72, nr.74 /2014 “Për armët dhe per perdorimin e armeve te zjarrit”.

Sherbimi i rojeve per çdo objekt duhet te siguroje, rendin dhe qetesine per personelin, konform ligjit nr. 75/2014 “Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike” te ndryshuar.

Shoqeria duhet te kete seriozitet ne kryerjen e sherbimit, paraqitje te rregullt dhe duhet te jete e pajisur nga ana tekniko-materiale per perballimin e ketij sherbimi.

Shërbimi i ruajtjes e sigurimit fizik të objekteve do të jetë 24 orë për çdo ditë kalendarike, sipas afateve të kontratës. Vendroja do të jetë e pajisur me armatimin e domosdoshëm dhe me pajisjet ndihmëse që përcaktohen në ligjet dhe udhëzimet përkatëse.

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim me SHRSF-në si dhe për parandalimin e ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka nën ruajtje dhe nën përgjegjësinë personale të tij.

Ne cdo vend roje do te kete keto dokumenta:

- Rregullorja e brendeshme;
- Grafiku i sherbimit;
- Inventari i materialeve qe ndodhen ne objekt;
- Mjete ndricimi ne rast mungese se energjis elektrike;
- Numra telefonik te Drejtorive se Policise,M.K.Z. dhe te personave kryesor pergjegjes te objekteve;
- Skemen e njoftimit ne rast sulmi ose zjarri ne objekt;
- Listen e automjeteve qe lejohen te hyjne apo te parkohen ne objekt.
- Gjate kryerjes se sherbimit roja nuk duhet te konsumoje pije alkolike,nuk do te fleje.

Objektivat: Te siguroje personelin, percaktuar ne dokumentet e tenderit.

Detyrat: Sigurimi normal i veprimtarise se Sh.a .U.K.T .

Krijimi i kushteve per sherbim sa me korrekt ndaj qytetareve.

### **Shpërndarja:**

Shperndarja do te jete sipas tabelës me vendrojet qe jane ne kete prokurim ne vendet perkatese.

---

Afati i kryerjes të shërbimit: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër ( Kjo marreveshje kuadër dhe cdo minikontratë e lidhur me subjektin privatë të shërbimit të sigurisë do të konsiderohet e zgjidhur nëse shoqëria “Illyrian Guard” shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë.

---

## **Shtojca 7**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur

---

duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

***Shënim:****Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vlerën 1,392,471.67 ( një milion e e treqind e nentëdhjete e dy mijë e katerqind e shtatëdhjete e një presje gjashtëdhjetë e gjashtë ) dhe në monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 10.10.2023 është 13, 182,53 (trembedhjetë mijë e njëqind e tetëdhjete e dy presje pesëdhjete e tre )euro

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A” si dhe në kategorinë ”1.3.B” për shoqërimin e vlerave monetare si dhe të sendeve të çmuara lëshuar nga organi kompetent, konform

---

---

Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqese ne sistemin e prokurimit publik Licencë të drejtuesit teknik për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A”me kohe te plote si dhe në kategorinë ”1.3.B” me kohe te plote për shoqërimin e vlerave monetare si dhe të sendeve të çmuara lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

3. Operatori ekonomik duhet te praraqese certifikatat e punonjesve te sherbimit për jo më pak se **45** punonjës për nënkategorinë 1.3.A, konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqeruar me listen emerore te punonjesve te sherbimit te punesuar ne DVP, Tirane (te vlefshme brenda 4 viteve) te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori. Punonjesit e pasqyruar ne listen emerore te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori duhet te figurojne ne listepagesat e sigurimeve shoqerore minimumi 3 muajt fundit. Ne rast bashkimi te operatorve ekonomik , kjo liste duhet te paraqitet ne perputhje me perqindjen e marr persiper në kontratën e bashkëpunimit.

**Shënim:** Përsa i perket listepagesve te sigurimeve shoqerore minimumi 3 mujat e fundit te operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kushteve të përgjithshme të kualifikimit.

**b. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

**2.2.2.**Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3(tre) viteve te fundit 2020, 2021, 2022 . Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, te konfirmuara nga Autoriteti perkates.Ky kriter quhet ti permbushur nese ne bilancete 2 viteve te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit .

**2.2.3.**Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

**2.2.4.**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në

---

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 27,849,433.4 (nëzet e shtatë milion e teteqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e tre )lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit (përllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**4.2.** Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga AKEP konform ligjit Nr. 9918 datë 19/05/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zone mbulimi Qarkun i Tiranës.

**4.3** Operatorët ekonomik duhet të disponojnë qendër kontrolli në Qarkun Tiranë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik Akt Miratim të lëshuar nga DVP Tirane sipas ligjit në fuqi.

**4.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve publike Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane jo më parë se 6 muajt e fundit, përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon:

e) Punonjes shërbimi të kategorisë 1.3.A. jo më pak se 45 punonjes shërbimi.

f) Përgjegjës shërbimi 3 punonjes.

g) Operatori i kontrollit 5 punonjes.

h) Numri i armeve të gjata, kategoria (B4) jo më pak se 10 copë në DVP Tirane.



---

**Shënim:** Për piken 4.4 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 automjete dhe 2 motora.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar më lart operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentacionin e mëposhtëm:

Ne rastet kur mjetet jane ne pronesi:

- Certifikat Pronesie,
- Leje Qarkullimi,
- Siguracion (i vlefshëm)
- Kontroll Teknik
- Takse Vjetore.

Ne rastet kur mjetet jane me qera:

- Kontrate Qeraje në formën noteriale e cila të mbulojë gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar nga AK.
- Certifikatë Pronesie,
- Leje Qarkullimi,
- Siguracion,( i vlefshëm)
- Kontroll Teknik
- Takse Vjetore.

**Shënim:** Për pikat 4.5 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin ne sistemin e porkurimt publik formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për

---

vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.6** Operatori ekonomik duhet të paraqese ne sistemin elektronik të prokurimeve Vertetim leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane jo më parë se viti 2022, kategoria 1.3.B, konform ligjit nr.75/2014 dhe akteve nenligjore në fuqi për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon:

f) Jo më pak se 15 punonjës shërbimi, të kategorisë 1.3.B.

g) Jo më pak se 3 përgjegjës eskorte.

h) Jo më pak se 10 copë arme të gjata kategoria (B4) në DVP Tirane.

i) Operatorët ekonomikë të mos kenë marrë masa administrative për periudhën Janar 2022 e në vazhdim

j) Operatorët ekonomikë të mos kenë ngjarje për periudhën Janar 2022 e në vazhdim.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej operatorëve pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetimin e leshuar nga drejtoria vendore e policisë Tiranë.

**Shënim:** Për pikat 4.6 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë ne sistemin elektronik të prokurimeve certifikatat e punonjësve të shërbimit për jo më pak se 45 punonjës për nënkategorinë 1.3.A dhe 15 punonjës shërbimi për nënkategorinë 1.3.B konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqëruar me listën emergjente të punonjësve të shërbimit të punësuar në DVP Tirane (të vlefshme) të nënshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori. Punonjësit e pasqyruar në listën emergjente të nënshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori duhet të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqërore minimumi 3 muajt e fundit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik lista emergjente duhet të paraqitet në përputhje me përqindjen e marrë për siper në kontratën e bashkëpunimit.

**Shënim:** Përsa i përket listepagesave të sigurimeve shoqërore minimumi 3 muajt e fundit operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.8** Për shoqërimin e vlerave monetare operatori ekonomik duhet të disponojë 8 autoblinda, **niveli i blindimit të jetë jo më pak se BR4**. Për të vërtetuar disponimin e këtyre blindave, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin në vijim:

Në rastet kur autoblindat janë në pronësi:

- 
- Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
  - Certifikatë Pronesie,
  - Leje qarkullimi,
  - Kontroll teknik,
  - Taksat e mjetit
  - Siguracioni i mjetit (e vlefshme)

Ne rastet kur autobлиндat janë me qira:

- Kontrate Qeraje në formën noteriale për gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në emër të qiramarrësit,
- Certifikatë Pronesie,
- Leje Qarkullimi,
- Kontroll Teknik,
- Taksat e Mjetit
- Siguracioni i Mjetit (e vlefshme)

**Shënim:** Për pikat 4.8 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin në sistemin elektronik të prokurimeve formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.9** .Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Qershor 2023 korrik 2023 Gusht 2023) , shoqëruar me listpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e kërkuar më lart.

Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 63 punonjës të siguruar në muajt nga të cilët 60 punonjës shërbimi si dhe Drejtuesit Teknikë dhe Administratorin.

**Shënim:** Për pikat 4.9 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**4.10** Operatori Ekonomik ofertues në zbatim të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" neni 22 i tij, duhet të ketë në stafin teknik 1 (një) inxhinier elektronik/teknologji informacioni/, inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike.

---

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqetë dokumentacionin (diplomë, kontrata e punës).

Prania e inxhinierit është i nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të sallës së kontrollit dhe sistemin e alarmit i cili duhet të figurojë ne listpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej operatorëve ekonomikë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar më lart.

**Shënim:** Për pikat 4.10 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

**4.11.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë preventivin dhe analizën e kostos së shërbimit për një roje në muaj ne perputhje me parashikimet e Shtojcës 1, duke u mbështetur në legjislacionin ne fuqi qe rregullon marrdheniet e punes per Punonjesit e Sherbimit dhe sherbimin. *Mosparaqitja e këtij preventivi, analizës së cmimit dhe ofertimi nën kosto minimale ligjore përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.*

*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik "i ndryshuar, si dhe te respektojne rigorozisht udhezimet e APP per operatorete ekonomike per rastin e bashkimit te operatoreve ne procedurat elektronike te prokurimit .*

